



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.66**

**20 maj**

**2008**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9906 datë 24.4.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar” .....	2899
Ligj nr.9907 datë 24.4.2008	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.2, datë 8.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për dërgimin në Bosnjë-Hercegovinë të një grupi të asgjësimit të municioneve dhe eksplozivëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për të marrë pjesë në operacionin “ALTHEA” të Bashkimit Europian” .....	2903
Ligj nr.9908 datë 24.4.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9362, datë 24.3.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve” .....	2903
Ligj nr.9909 datë 5.5.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë për mbrojtjen e ndërsjellë dhe shkëmbimin e informacionit të klasifikuar” .....	2907
Vendim i Kuvendit nr.181, datë 5.5.2008	Për miratimin e strukturës dhe organikës së Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE) .....	2912
Vendim i Kuvendit nr.182, datë 12.5.2008	Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës .....	2915
Vendim i Kuvendit nr.183, datë 12.5.2008	Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive .....	2918

Rezolutë e Kuvendit datë 5.5.2008	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2007 .....	2921
Rezolutë e Kuvendit datë 5.5.2008	Për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2007 .....	2922
Rezolutë e Kuvendit datë 5.5.2008	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2007.....	2923
Rezolutë e Kuvendit datë 12.5.2008	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Telekomunikacioneve për vitin 2007 .....	2924
Rezolutë e Kuvendit datë 12.5.2008	Për vlerësimin e veprimtarisë së Rediotelevizionit Shqiptar për vitin 2007 .....	2925
Dekret nr.5698 datë 5.5.2008	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare .....	2926
Dekret nr.5699 datë 6.5.2008	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare .....	2927

Çmimi 32 lekë

**LIGJ**  
**Nr.9906, datë 24.4.2008**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KABINETIT TË MINISTRAVE TË UKRAINËS PËR MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5702, datë 6.5.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KABINETIT TË MINISTRAVE TË UKRAINËS PËR MBROJTJEN RECIPROKE TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Kabineti i Ministrave të Ukrainës, këtu e më poshtë referuar si “Palët Kontraktuese”, me qëllim që:

- të sigurojnë mbrojtjen të informacionit të klasifikuar të shkëmbyer midis Palëve, brenda kontekstit të marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura ose të marrëveshjeve që do të lidhen brenda kontekstit të procedurave të ofruara, kontratave ose rregullave të secilit subjekt, publik apo privat, të shteteve të Palëve;

- të konfirmojnë që kjo Marrëveshje nuk do të ketë efekt në angazhimet e të dyja Palëve, që rezultojnë ndaj marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare dhe që ajo nuk do të përdoret kundër interesave, sigurisë dhe integritetit territorial të shteteve të tjera,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

**Përkufizimet**

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

1. “Informacioni i klasifikuar” do të thotë çdo lloj e dhëne, pavarësisht nga karakteristikat dhe forma e saj fizike, si dhe mjetet e transmetimit, që ka qenë e klasifikuar në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palëve, dhe në interes të sigurisë kombëtare, dhe në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Palëve, kërkon mbrojtje ndaj aksesit të paautorizuar.

2. “Pala marrëse” do të thotë pala në këtë Marrëveshje, tek e cila transmetohet informacioni i klasifikuar.

3. “Pala e origjinës” do të thotë Pala në këtë Marrëveshje që e inicion informacionin e

klasifikuar.

4. “Autoriteti kompetent i sigurimit” do të thotë autoriteti shtetëror, i cili, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, është përgjegjës për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

5. “Kontraktues” do të thotë një person fizik apo juridik, që ka kapacitetin ligjor të ndërmarrë dhe të zbatojë kontrata në përputhje me këtë Marrëveshjeje.

6. “Kontratë e klasifikuar” do të thotë një marrëveshje ndërmjet dy apo më shumë kontraktorëve, që krijojnë dhe përcaktojnë të drejta dhe obligime të detyrueshme ndërmjet tyre, e cila përmban apo përfshin informacion të klasifikuar.

7. “Palë e tretë” do të thotë një organizatë ndërkombëtare apo shtet i tretë që nuk është palë e kësaj Marrëveshjeje.

8. “Vizitor” do të thotë një përfaqësues zyrtar i një pale, që kërkon të vizitojë ambientet e palës tjetër, që janë të përfshira në aktivitete me informacion të klasifikuar.

9. “Certifikatë sigurie” do të thotë dokumenti që lëshohet nga autoriteti kompetent i sigurimit për një qytetar të një pale për akses në informacionin e klasifikuar, në përputhje me legjislacionin e brendshëm respektiv.

10. “Certifikatë sigurie pajisjeje” do të thotë dokumenti i lëshuar nga autoriteti kompetent i sigurimit, në përputhje me legjislacionin e brendshëm respektiv, që provon se kompania/pajisja ka aftësinë organizative dhe fizike të përdorë dhe të depozitojë informacion të klasifikuar.

## Neni 2

### **Autoritetet kompetente të sigurimit**

1. Autoritetet kompetente të sigurimit të shteteve palë, përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, janë si më poshtë:

- Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Drejtori e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurimit Kombëtar).

- Për kabinetin e Ministrave të Ukrainës:

Shërbimi i Sigurimit të Ukrainës.

2. Autoritetet kompetente të sigurimit do ta sigurojnë njëra-tjetrën me kërkesat e tyre zyrtare.

3. Me qëllim që të arrihen dhe të mbahen standarde të krahasueshme sigurimi, autoritetet kompetente të sigurimit respektiv, me kërkesë, do të sigurojnë njëra-tjetrën me informacion rreth procedurave, praktikave dhe standardeve të sigurimit për ruajtjen e informacionit të klasifikuar në shtetin e palës respektive.

## Neni 3

### **Parimet e sigurisë**

1. Palët do të marrin të gjitha masat e nevojshme, në përputhje me legjislacionin e brendshëm respektiv, në mënyrë që të sigurojnë mbrojtje të përshtatshme të informacionit të klasifikuar të marrë në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe kontratave të klasifikuara të realizuara ndërmjet Palëve.

2. Mbrojtja dhe përdorimi i informacionit të klasifikuar, i shkëmbyer midis Palëve, do të ekzekutohet në përputhje me parimet e vendosura më poshtë:

a) Pala marrëse do të garantojë që informacioni i klasifikuar i marrë është shenjëzuar me një klasifikim të njëjtë sigurie, në përputhje me nenin 4.

b) Aksesi në informacionin e klasifikuar do të lejohet vetëm për personat, funksionet e të cilëve e kërkojnë atë në bazë të parimit të “nevojës për njohje” dhe që, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, iu është lëshuar më parë certifikatë sigurie e nivelit të duhur.

c) Palët do të njohin reciprokisht certifikatën e sigurisë, lëshuar përfaqësuesve të tyre të autorizuar.

d) Pala marrëse nuk do t'i japë informacion të klasifikuar një pale të tretë pa aprovimin më parë me shkrim të palës së origjinës.

e) Informacioni i klasifikuar i dhënë nuk do të përdoret për qëllime të tjera përveç atij për të cilin

ai është siguruar.

f) Pala marrëse nuk do të ulë ose të heqë nivelin e klasifikimit të informacionit të klasifikuar të marrë pa miratimin me shkrim më parë të palës së origjinës.

#### Neni 4

### Klasifikimet e sigurisë dhe ekuivalencat e tyre

1. Klasifikimet e sigurisë dhe ekuivalencat e palëve janë:

Për Palën Shqiptare	Ekuivalenca në anglisht	Për Palën Ukrainase
Тепër sekret	Top sekret	ОСОБЛИВОЇ ВАЖЛИВОСТІ
Sekret	Secret	ЦІЛКОМ ТАЄМНО
Konfidencial	Confidential	ТАЄМНО

#### Neni 5

### Shenjzimi i informacionit të klasifikuar

1. Kur informacioni i klasifikuar është marrë, pala marrëse duhet të sigurohet që ai është shenjzuar me klasifikimet e sigurisë kombëtare, në përputhje me nenin 4.

2. Pala marrëse duhet të sigurojë të njëjtin klasifikim sigurie për kopjet dhe përkthimet, ashtu si për dokumentin origjinal dhe do të sigurojë të njëjtën mbrojtje.

3. Autoritetet kompetente të sigurisë të shteteve të Palëve duhet të informojnë menjëherë njëra-tjetrën për të gjitha ndryshimet në nivelin klasifikimit të sigurisë të informacionit të klasifikuar të dhënë.

#### Neni 6

### Masat e sigurisë

1. Përpara dërgimit të informacionit të klasifikuar të dhënë nga njëra prej palëve te kontraktorët e palës tjetër, autoriteti kompetent i sigurimit të shtetit të palës marrëse:

a) do të sigurohet se brenda ambienteve të kontraktorëve të shtetit të palës marrëse, mbrojtja e informacionit të klasifikuar sigurohet në një mënyrë të përshtatshme;

b) do t'i lëshojë këtyre kontraktorëve certifikatë sigurie pajisjeje të nivelit të kërkuar, në rast se këto kontraktorë përmbushin kriteret për këtë lëshim në përputhje me legjislacionin e brendshëm;

c) do t'i lëshojë certifikatën e sigurisë të nivelit të kërkuar personave që u nevojitet akses tek informacioni i klasifikuar gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare, në rast se këta persona përmbushin kriteret për këtë, në përputhje me legjislacionin e brendshëm;

d) do të sigurojë që të gjithë personat që do të kenë akses në informacionin e klasifikuar të marrë, janë trajnuar saktësisht mbi procedurat e sigurisë dhe detyrimet e tyre të sigurisë.

2. Gjatë negociatave mbi kontratat e klasifikuara midis kontraktorëve të Palëve, autoriteti kompetent i sigurisë i shtetit të palës së origjinës do të informojë homologun e tij për nivelin e informacionit të klasifikuar lidhur me këto negociata.

3. Masat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, si dhe procedurat për vlerësimin dhe dëshmipërblimin për humbjet e shkaktuara kontraktorit nga zbulimi i paautorizuar i informacionit të klasifikuar, duhet të specifikohen me më shumë detaje në kontratën e klasifikuar respektive. Palët do të sigurojnë kryerjen e inspektimeve të sigurisë të rregullta të ambienteve që mbajnë informacion të klasifikuar të marrë nga pala tjetër.

4) Çdo shtojcë sigurie do të jetë një pjesë integrale e secilës kontratë të klasifikuar. Autoriteti kompetent i sigurisë i shtetit të palës së origjinës do të miratojë këtë shtojcë dhe do të dorëzojë një kopje tek autoriteti kompetent i sigurisë i shtetit të palës marrëse. Vetëm pala e origjinës mund të ndryshojë nivelin e klasifikimit të vendosur në shtojcën e sigurisë.

#### Neni 7

### Transmetimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar do t'u transmetohet Palëve nëpërmjet kanaleve diplomatike. Kontraktori i shtetit të palës marrëse do të konfirmojë me shkrim marrjen e informacionit të klasifikuar.

2. Në raste të veçanta dhe pas pëlqimit reciprok, autoritetet kompetente të sigurisë mund të përcaktojnë mënyra të tjera të transmetimit të informacionit të klasifikuar.

3. Transmetimi i informacionit të klasifikuar nëpërmjet mjeteve të komunikimit do të bëhet vetëm në formë të kriptuar, të aprovuar nga autoritetet kompetente të sigurisë.

#### Neni 8

##### **Vizitat**

1. Vizitorëve të një pale do t'u lejohet aksesi në informacionin e klasifikuar të shtetit të palës tjetër, në hapësirën e nevojshme dhe mjediset fizike ku informacioni i klasifikuar mbahet, vetëm pas marrjes paraprake të një lejeje me shkrim të lëshuar nga autoriteti kompetent i sigurimit të shtetit të palës tjetër.

2. Leja, e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, do t'u jepet vetëm vizitorëve të autorizuar për akses në informacionin e klasifikuar, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm.

3. Për të marrë lejen e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, të dhënat personale të vizitorëve, sipas kërkesës, do t'i transmetohen autoritetit kompetent të sigurisë të shtetit të palës pritëse më përpara.

4. Autoritetet kompetente të sigurisë të shteteve të Palëve do të informojnë njëra-tjetrën për detajet e kërkesës për vizitë dhe do të sigurojnë mbrojtje të të dhënave personale.

#### Neni 9

##### **Shkelja e rregullave të sigurisë**

1. Në rast se një shkelje e legjislacionit të brendshëm mbi mbrojtjen e informacionit të klasifikuar nuk përjashtohet, ose në qoftë se ajo konsiderohet që të ketë ndodhur apo të jetë konstatuar dhe në rast se kjo shkelje mund të ketë një indikim në mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të dërguar sipas kësaj Marrëveshjeje, ky fakt duhet të njoftohet menjëherë me shkrim nga autoriteti kompetent i sigurisë i shtetit të palës marrëse tek autoriteti kompetent i sigurisë i shtetit të palës së origjinës.

2. Çdo rast i shkeljes së legjislacionit të brendshëm mbi mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, siç përmendet në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të jetë subjekt i një hetimi dhe masave përkatëse të marra në përputhje me legjislacionin e brendshëm të shtetit të palës marrëse.

Autoriteti kompetent i sigurisë i shtetit të palës së origjinës duhet të informohet për rezultatet e këtij hetimi.

#### Neni 10

##### **Shpenzimet**

Çdo palë do të mbulojë shpenzimet e saj, që do të rezultojnë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 11

##### **Konsultimet dhe inspektimet**

1. Me qëllim që të sigurohet një bashkëpunim i ngushtë gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të sigurisë të shteteve të Palëve do t'i sigurojnë njëra-tjetrës konsultime, sipas kërkesës.

2. Për të mbajtur standarde të krahasueshme sigurie, autoritetet kompetente të sigurisë të shteteve të palëve do t'i sigurojnë njëra-tjetrës legjislacionin e brendshëm përkatës.

3. Autoritetet kompetente të sigurisë të shteteve të Palëve kanë të drejtë të inspektojnë kushtet në të cilat mbahet informacioni i klasifikuar i shkëmbyer.

#### Neni 12

##### **Dispozita të fundit**

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pakufizuar kohe.  
2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim mbi përmbushjen nga Palët të procedurave kombëtare që janë të nevojshme për hyrjen në fuqi të saj.

3. Çdo palë mund të paraqesë në çdo kohë një propozim me shkrim për të ndryshuar këtë Marrëveshjeje.

Nëse miratohet nga të dyja Palët, ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje do të bëhen një pjesë integrale e Marrëveshjes dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni.

4. Çdo mosmarrëveshje në interpretimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve midis përfaqësuesve të autorizuar të shteteve të Palëve.

5. Çdo palë mund të përfundojë këtë Marrëveshjeje në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim 6 muaj më parë. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, informacioni i klasifikuar, i shkëmbyer ose krijuar do të vazhdojë të mbahet në përputhje me këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë më 5.2.2008, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, ukrainase dhe angleze, të gjitha tekstet janë autentike dhe me të njëjtën vlerë. Në rast keqinterpretimi të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, teksti në anglisht do të ketë prioritet.

#### **LIGJ**

**Nr.9907, datë 24.4.2008**

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 2, DATË 8.4.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DËRGIMIN NË BOSNJË-HERCEGOVINË TË NJË GRUPI TË ASGJËSIMIT TË MUNICIONEVE DHE EKSPLOZIVËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR TË MARRË PJESË NË OPERACIONIN “ALTHEA” TË BASHKIMIT EUROPIAN”**

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### **KUVENDI**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### **VENDOSI:**

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.2, datë 8.4.2008, i Këshillit të Ministrave “Për dërgimin në Bosnjë-Hercegovinë të një grupi të asgjësimit të municioneve dhe eksplozivëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për të marrë pjesë në operacionin “ALTHEA” të Bashkimit Europian”.

**Shpallur me dekretin nr.5703, datë 6.5.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

#### **LIGJ**

**Nr.9908, datë 24.4.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9362, DATË 24.3.2005  
“PËR SHËRBIMIN E MBROJTJES SË BIMËVE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### **KUVENDI**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

## VENDOSI:

Në ligjin nr.9362, datë 24.3.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

### Neni 1

Kudo në ligj ndryshohen emërtimet si më poshtë:

a) emërtimi “Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit” zëvendësohet me emërtimin “ministra që mbulon fushën e bujqësisë”;

b) emërtimi “Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit” zëvendësohet me emërtimin “ministri që mbulon fushën e bujqësisë”;

c) emërtimi “Drejtoria e Mbrojtjes së Bimëve” zëvendësohet me emërtimin “struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve (SPMB)”;

ç) emërtimi “Drejtori i Mbrojtjes së Bimëve” zëvendësohet me emërtimin “drejtuesi i strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së bimëve”;

d) emërtimi “Instituti i Kërkimeve Veterinare” zëvendësohet me emërtimin “Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë”;

dh) emërtimi “Instituti i Mbrojtjes së Bimëve” zëvendësohet me emërtimin “Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve (DMB) në Universitetin Bujqësor, Tiranë”.

### Neni 2

Pas pikës 4 të nenit 2 shtohen pikat 4.1 e 4.2 me këtë përmbajtje:

“4.1 “PMB të rrezikshme” janë PMB-të e klasifikuara:

- a) eksplozive;
- b) oksiduese;
- c) ekstremisht të ndezshme;
- ç) lehtësisht të ndezshme;
- d) të ndezshme;
- dh) shumë helmuese;
- e) helmuese;
- ë) të dëmshme;
- f) gërryese;
- g) irritante;
- gj) të ndjeshme;
- h) kancerogjene;
- i) mutagjene;
- j) helmuese për riprodhimin;
- k) të rrezikshme për mjedisin.

4.2 “PMB me rrezik të lartë” janë PMB-të e klasifikuara:

- a) shumë helmuese (të klasës 1a ose T+);
- b) helmuese (të klasës 1b ose T);
- c) ekstremisht të ndezshme;
- ç) lehtësisht të ndezshme;
- d) të rrezikshme për mjedisin.”.

### Neni 3

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Shërbimi i mbrojtjes së bimëve përbëhet nga:

- a) Struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve;
- b) Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV);
- c) Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve (DMB) në Universitetin Bujqësor, Tiranë, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.”.

#### Neni 4

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 5

#### **Laboratorët e referencës dhe laboratorët e autorizuar të kontrollit**

1. Laboratorë reference janë:

1.1. Laboratorët e diagnostikimit të parazitëve pranë Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve (DMB) në Universitetin Bujqësor, Tiranë, të cilët kanë për detyrë:

- a) të monitorojnë parazitët karantinorë, të përcaktojnë statusin e tyre, mënyrat e kontrollit karantinor dhe të njoftojnë ministrinë që mbulon fushën e bujqësisë;
- b) të bëjnë diagnostikimin dhe prognozë-sinjalizimin e parazitëve, duke përcaktuar edhe masat e luftimit të tyre;
- c) të bëjnë provat biologjike-agronomike të PMB-ve gjatë procedurës së regjistrimit të tyre.

1.2. Laboratori i analizave cilësore të PMB-ve, si dhe i mbetjeve të tyre pranë Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), i cili ka për detyrë:

- a) të bëjë analizat fiziko-kimike të PMB-ve gjatë procedurës së regjistrimit të tyre;
- b) të bëjë kontrollin cilësor të PMB-ve dhe të mbetjeve të tyre në bimët dhe produktet bimore.

2. Krahas detyrave të përcaktuara në pikat 1.1 e 1.2, laboratorët e referencës duhet, gjithashtu:

a) të bëjnë vlerësimin e laboratorëve të autorizuar të kontrollit, nëse janë të pajisur për kryerjen e analizave për kontrollin zyrtar. Ky vlerësim shërben për autorizimin e tyre nga ministri që mbulon fushën e bujqësisë;

b) të bashkërendojnë punën dhe të ofrojnë mbështetje, përfshirë trajnime dhe shërbime të tjera për veprimtaritë laboratorike, për standardet teknike dhe mënyrat e analizave që ato kryejnë;

c) të organizojnë teste paralele të mostrave të standardizuara dhe të marrin pjesë në to në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për monitorimin e kualifikimit të laboratorëve të autorizuar të kontrollit;

ç) të garantojnë se laboratorët e autorizuar të kontrollit përdorin sistemin e tyre të brendshëm, në përputhje me standardet e kërkuara.

3. Për zbatimin e detyrave të përcaktuara në pikën 1.1 të këtij neni, ministria që mbulon fushën e bujqësisë lidh marrëveshje kontraktuale (kontratë) me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

4. Laboratorët e autorizuar të kontrollit miratohen nga ministri që mbulon fushën e bujqësisë, pas vlerësimit të kryer nga laboratorët e referencës. Si laboratorë të autorizuar të kontrollit shërbejnë laboratorët e mbrojtjes së bimëve pranë DRBUMK-së në qarqe, si dhe ato private, nëse plotësojnë kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

5. Kriteret që duhet të plotësojnë laboratorët e autorizuar të kontrollit për t'u miratuar, procedurat e miratimit dhe analizat që kryejnë përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.

6. Tarifat e analizave që kryhen nga laboratorët e referencës dhe laboratorët e autorizuar të kontrollit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë dhe të Ministrit të Financave.”.

#### Neni 5

Në nenin 21 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në Republikën e Shqipërisë regjistrohen vetëm PMB-të, të cilat janë të regjistruara në vendet e Bashkimit Europian.”.

#### Neni 6

Në nenin 23 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Importimi i PMB-ve të regjistruara, të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë”, kryhet me leje importi, të lëshuar nga drejtuesi i strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së bimëve, ndërsa importimi i PMB-ve të tjera kryhet sipas parimit të autodeklarimit.”.

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Tregtimi i PMB-ve të regjistruara, të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë”, kryhet me leje tregtimi, të lëshuar nga drejtori i DRBUMK-së në qark, ndërsa tregtimi i PMB-ve të tjera kryhet sipas parimit të autodeklarimit.”.

c) Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Formulari i autodeklarimit për importin e PMB-ve dorëzohet në ministrinë që mbulon fushën e bujqësisë, ndërsa formulari për tregtimin e tyre dorëzohet në DRBUMK-në e qarkut.”.

#### Neni 7

Në nenin 25, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. PMB-të e klasifikuara “PMB me rrezik të lartë” përdoren vetëm nga personat e përmendur në pikën 1 dhe nga ata që janë të pajisur me dëshmi aftësie të veçantë. PMB-të e klasifikuara “PMB të rrezikshme” përdoren nga persona të pajisur me dëshmi aftësie, ndërsa ato të klasifikuara “PMB-të e tjera” përdoren pa dëshmi.”.

#### Neni 8

Në nenin 27 bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 8, pas fjalëve “në kundërshtim me kërkesat e nenit 23” shtohen fjalët “pikat 2, 3 e 4”.

b) Pas pikës 10 shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:

“11. Importimi dhe tregtimi i PMB-ve, në kundërshtim me kërkesat e pikës 1 të nenit 23 të këtij ligji.”.

#### Neni 9

Në fund të nenit 28 shtohen pikat 5 e 6 me këtë përmbajtje:

“5. Për kundërvajtjet administrative të parashikuara në pikën 11 të nenit 27 të këtij ligji jepet dënim me gjobë 50 000 lekë, si dhe detyrohet subjekti të kthejë PMB-të në vendin e origjinës së marrjes së tyre.

6. Në rast përsëritjeje të kundërvajtjeve administrative të parashikuara në pikat 8 e 9 të nenit 27 të këtij ligji, subjektit i jepet dënim me gjobë 50 000 lekë dhe i hiqet e drejta e importimit ose e tregimit të PMB-ve.”.

#### Neni 10

Ngarkohet Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit që, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të bëjë rivlerësimin e regjistrimeve të PMB-ve të kryera, sipas kërkesave të parashikuara në këtë ligj.

#### Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5704, datë 6.5.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ  
Nr.9909, datë 5.5.2008**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË BULLGARISË PËR MBROJTJEN E NDËRSJELLË DHE SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë për mbrojtjen e ndërsjellë dhe shkëmbimin e informacionit të klasifikuar”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5727, datë 19.5.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË BULLGARISË MBI MBROJTJEN RECIPROKE DHE  
SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë, më poshtë të referuara si “Palët”,

- *duke rënë* dakord të zhvillojnë bisedime në lidhje me çështjet politike dhe të sigurisë dhe të zgjerojnë dhe forcojnë bashkëpunimin e tyre politik, ushtarak dhe ekonomik;

- *duke qenë* të ndërgjegjshëm për ndryshimet në situatën politike në botë dhe duke njohur rolin e rëndësishëm të bashkëpunimit të tyre reciprok për forcimin e paqes, sigurisë ndërkombëtare dhe besimit të ndërsjellë;

- *duke ditur* që bashkëpunimi i mirë mund të kërkojë shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet Palëve;

- *me dëshirën* për të vendosur një grup rregullash që të rregullojnë mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar, të zbatueshme për çdo marrëveshje bashkëpunimi dhe kontratat e klasifikuara të ardhshme që do të zbatohen ndërmjet Palëve, që përmbajnë ose përfshijnë informacion të klasifikuar,

kanë rënë dakord si më poshtë.

**Neni 1**

**Përkufizime**

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

1. “Informacion i klasifikuar” është informacion në çfarëdolloj forme, natyre ose metode transmetimi, i prodhuar ose në proces prodhimi, të cilit i është caktuar një nivel i klasifikimit të sigurisë dhe që, në interes të sigurisë kombëtare e në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore të brendshme, kërkon mbrojtje ndaj aksesit të paautorizuar ose shkatërrimit.

2. “Aksesi i paautorizuar i informacionit të klasifikuar” është çdo formë deklarimi e informacionit të klasifikuar, abuzim, dëmtim, dhënie, asgjësim dhe klasifikim i gabuar i tij, si dhe veprime të tjera që rezultojnë në shkeljen e mbrojtjes ose humbjen e këtij informacioni, si dhe çdo veprim ose mosveprim që ka rezultuar në zbulimin e informacionit ndaj personave të paautorizuar.

3. “Dokument i klasifikuar” është çdo formë e informacionit të klasifikuar të regjistruar, pavarësisht nga karakteristikat ose tipin e mjetit regjistruar.

4. “Material i klasifikuar” është çdo dokument i klasifikuar ose mjet teknik, pajisje, instalim, vegël ose armë që është prodhuar ose në proces prodhimi, si dhe pjesët përbërëse që përdoren për prodhimin e tyre, që përmbajnë informacion të klasifikuar.

5. “Niveli i klasifikimit të sigurisë” është kategoria që, në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore të brendshme, karakterizon rëndësinë e informacionit të klasifikuar, nivelin e kufizimit të mundësit të marrjes së tij dhe nivelin e mbrojtjes së tij nga Palët dhe gjithashtu kategorinë, mbi bazën e së cilës shënohet informacioni.

6. “Shënimi i klasifikimit” është një shënim në çdo material të klasifikuar, që tregon nivelin e klasifikimit të sigurisë.

7. “Certifikatë sigurie” është një vendim pozitiv që është rezultat i një procedure verifikimi që konfirmon besnikërinë dhe besueshmërinë e një individi ose të një subjekti juridik, si dhe aspekte të tjera të sigurisë, në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore të brendshme. Një vendim i tillë jep mundësi për t’i lejuar individit ose subjektit juridik të marrë dhe përdorë informacion të klasifikuar në një nivel të caktuar, pa pasur rrezik sigurie.

8. “Pala e origjinës” është pala që transmeton informacion të klasifikuar.

9. “Pala pritëse” është Pala, së cilës i transmetohet informacioni i klasifikuar.

10. “Autoriteti kompetent” është autoriteti që, në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore të brendshme të Palës përkatëse, zbaton politikën e shtetit për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, ushtron kontroll të përgjithshëm në këtë sferë, si dhe kryen zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Këto autoritete renditen në nenin 5 të kësaj Marrëveshjeje.

11. “Kontraktori” është një individ ose një subjekt juridik, që ka tagrin ligjor të përfundojë kontrata të klasifikuara.

12. “Kontratë e klasifikuar” është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë kontraktorëve, që përmban ose mundëson marrjen e informacionit të klasifikuar.

13. Parimi “Nevojë për njohje” është domosdoshmëria për të pasur mundësinë e marrjes së informacionit të klasifikuar në lidhje me detyrat zyrtare dhe/ose për kryerjen e një detyre zyrtare konkrete.

14. “Palë e tretë” është një organizatë shtetërore ose ndërkombëtare, që nuk është palë në këtë Marrëveshje ose një individ apo subjekt juridik që nuk u nënshtrohet kërkesave të brendshme të mundësit të marrjes së informacionit të klasifikuar, duke përfshirë parimin e “nevojës për njohje”.

15. “Deklasifikim i informacionit” është heqja e nivelit të klasifikimit të sigurisë.

16. “Cenimi i sigurisë” është një veprim ose mosveprim në kundërshtim me ligjet dhe aktet nënligjore të brendshme që rezulton ose mund të rezultojë në mundësimin e marrjes së paautorizuar të informacionit të klasifikuar.

Neni 2

### Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është sigurimi i mbrojtjes së informacionit të klasifikuar që gjenerohet bashkërisht ose shkëmbehet ndërmjet Palëve.

Neni 3

### Nivelet e klasifikimit të sigurisë

Palët bien dakord që nivelet e mëposhtme të klasifikimit të sigurisë janë ekuivalente dhe përputhen me nivelet e klasifikimit të sigurisë, të përcaktuara në ligjet dhe aktet nënligjore të brendshme të palës përkatëse:

Për Republikën e Bullgarisë	Ekivalenti në anglisht	Për Republikën e Shqipërisë
СТРОГО СЕКРЕТНО	TOP SECRET	TEPËR SEKRET
СЕКРЕТНО	SECRET	SEKRET
ПОВЕРИТЕЛНО	CONFIDENTIAL	KONFIDENCIAL
ЗА СЛУЖЕБНО ПОЛЗВАНЕ	RESTRICTED	I KUFIZUAR

Neni 4

## **Masat e brendshme**

1. Në pajtim me ligjet dhe aktet e tyre nënligjore të brendshme, Palët zbatojnë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, që gjenerohet ose shkëmbehet në pajtim me këtë Marrëveshje. I njëjti nivel i mbrojtjes i sigurohet këtij informacioni të klasifikuar që parashikohet edhe për informacionin e klasifikuar të brendshëm me nivelin përkatës të klasifikimit të sigurisë.

2. Palët informojnë njëra-tjetrën në kohën e duhur në lidhje me çdo ndryshim në ligjet dhe aktet ligjore të brendshme që cenojnë mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Në këto raste, Palët informojnë njëra-tjetrën në pajtim me paragrafët 3 dhe 4 të nenit 5, me qëllim që të diskutojnë ndryshimet e mundshme në këtë Marrëveshje. Ndërkohë, informacioni i klasifikuar mbrohet në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes, nëse nuk bihet dakord ndryshe me shkrim.

3. Asnjë individ nuk ka të drejtë të marrë informacion të klasifikuar vetëm në sajë të gradës, pozicionit zyrtar ose miratimit të sigurisë të tij ose të saj. Marrja e informacionit të klasifikuar u lejohe vetëm atyre individëve që u është lëshuar një miratim sigurie dhe në pajtim me parimin “nevojë për njohje”.

4. Pala pritëse është e detyruar:

a) të mos i tregojë informacion të klasifikuar një pale të tretë pa pëlqimin paraprak, me shkrim, të autoritetit kompetent të palës së origjinës;

b) t'i caktojë informacionit të klasifikuar një nivel të klasifikimit të sigurisë të barazvlefshëm me atë që i jepet nga pala e origjinës;

c) të mos përdorë informacion të klasifikuar për qëllime të tjera nga ato për të cilat është dhënë;

d) të garantojë të drejtat private si: të drejtat e patentave, të drejtat e autorit, sekretet tregtare, që janë të përfshira në informacionin e klasifikuar.

5. Nëse një marrëveshje tjetër, që lidhet ndërmjet Palëve, përmban rregulla më rigorozë në lidhje me shkëmbimin ose mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, zbatohen këto rregulla.

### **Neni 5**

#### **Autoritetet kompetente**

1. Autoritetet kompetente të Palëve janë:

Për Republikën e Shqipërisë:

- Drejtoria për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (Autoritet i Sigurisë Kombëtare).

Për Republikën e Bullgarisë:

- Komisioni Shtetëror për Sigurinë e Informacionit (Autoritet i Sigurisë Kombëtare).

2. Autoritetet kompetente informojnë njëra-tjetrën në lidhje me ligjet dhe aktet nënligjore të brendshme në fuqi, që rregullojnë mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

3. Me qëllim që të sigurohet bashkëpunim i ngushtë në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente mund të mbajnë konsultime me kërkesën e bërë nga njëra prej tyre.

4. Me qëllim që të arrihen dhe ruhen standarde të krahasueshme të sigurisë, autoritetet kompetente përkatëse, sipas kërkesës, i japin njëra-tjetrës informacion në lidhje me standardet, procedurat dhe praktikat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të zbatuar nga Palët përkatëse.

5. Autoritetet kompetente përkatëse mund të përfundojnë dokumente ekzekutive në lidhje me këtë Marrëveshje.

6. Shërbimet e sigurisë së Palëve mund të shkëmbejnë dhe kthejnë informacion operativ dhe/ose të fshehtë, drejtpërdrejt me njëri-tjetrin, në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore të brendshme.

### **Neni 6**

#### **Transmetimi i informacionit të klasifikuar**

1. Si rregull, informacioni i klasifikuar transmetohet me anë të kanaleve diplomatike ose ushtarake, ose me mjete të tjera, që përmbushin kërkesat e ligjeve dhe akteve nënligjore të brendshme të Palëve. Pala pritëse konfirmon me shkrim marrjen e informacionit të klasifikuar.

2. Informacioni i klasifikuar mund të transmetohet me anë të sistemeve, rrjeteve të telekomunikimit dhe mjeteve të tjera elektromagnetike, të miratuara nga autoritetet kompetente dhe që

janë pajisur me një certifikatë në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore të brendshme të secilës palë.

3. Mjete të tjera të miratuara të transmetimit të informacionit të klasifikuar mund të përdoren vetëm nëse bihet dakord ndërmjet autoriteteve kompetente.

4. Në rastin e transmetimit të një dërgese të madhe, që përmban informacion të klasifikuar, autoritetet kompetente bihen bashkërisht dakord dhe miratojnë mjetet e transportit, itinerarin dhe masa të tjera të sigurisë.

#### Neni 7

##### **Përkthimi, riprodhimi, asgjësimi**

1. Dokumentet e klasifikuara të shënuara me nivelin e klasifikimit të sigurisë ЦТРОГО СЕКРЕТНО/TOP SECRET/TEPËR SEKRET përkthehen ose riprodhohen vetëm me leje me shkrim të autoritetit kompetent të palës së origjinës.

2. Të gjitha përkthimet e informacionit të klasifikuar bëhen nga individë që kanë miratimin e përshtatshëm të sigurisë. Këto përkthime mbajnë të njëjtin shënim për klasifikimin e sigurisë.

3. Kur riprodhohet informacioni i klasifikuar, të gjitha shënimet origjinale të sigurisë mbi to riprodhohen ose shënohen në secilën kopje. Ky informacion i riprodhuar i nënshtrohet të njëjtit kontroll si informacioni origjinal. Numri i kopjeve kufizohet në atë që kërkohet për qëllime zyrtare.

4. Materiali i klasifikuar asgjësohet ose modifikohet në atë masë që të parandalohet riprodhimi i tij i plotë ose i pjesshëm.

5. Pala e origjinës mund të ndalojë shprehimisht riprodhimin, ndryshimin ose asgjësimin e një materiali të klasifikuar, duke vënë një shënim në mbajtësin përkatës të informacionit të klasifikuar ose duke dërguar një njoftim të mëvonshëm. Nëse asgjësimi i materialit të klasifikuar ndalohet, ai i kthehet autoritetit kompetent të palës së origjinës.

6. Materiali i klasifikuar me nivelin e klasifikimit të sigurisë ЦТРОГО СЕКРЕТНО/TOP SECRET/TEPËR SEKRET nuk asgjësohet. Ai i kthehet autoritetit kompetent të palës së origjinës.

7. Në rastin e një situatë krize, që e bën të pamundur mbrojtjen dhe kthimin e informacionit të klasifikuar të gjeneruar ose transmetuar në pajtim me këtë Marrëveshje, informacioni i klasifikuar asgjësohet menjëherë. Pala pritëse njofton autoritetin kompetent të palës së origjinës në lidhje me asgjësimin e informacionit të klasifikuar sa më shpejt të jetë e mundur.

#### Neni 8

##### **Kontratat e klasifikuara**

1. Kontratat e klasifikuara përfundohen dhe zbatohen në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore të brendshme të secilës palë. Sipas kërkesës, autoriteti kompetent i secilës palë jep informacion nëse një kontraktori të propozuar i është dhënë certifikatë sigurie kombëtare, në pajtim me nivelin e kërkuar të klasifikimit të sigurisë. Nëse kontraktori i propozuar nuk ka një certifikatë sigurie, autoriteti kompetent i secilës palë mund të kërkojë që këtij kontraktori t'i jepet një certifikatë sigurie.

2. Një aneks sigurie është pjesë përbërëse e secilës kontratë ose nënkontratë të klasifikuar. Në këtë aneks, kontraktori i palës së origjinës përcakton se cili informacion i klasifikuar i jepet ose gjenerohet nga pala pritëse dhe cili nivel përkatës sigurie i është dhënë këtij informacioni.

3. Detyrimi i kontraktorit për të mbrojtur informacionin e klasifikuar i referohet, të paktën, sa më poshtë:

a) detyrimin që kontraktori do t'ia deklarojë informacionin e klasifikuar vetëm një personi që ka marrë paraprakisht certifikatë sigurie për marrjen njohuri në lidhje me aktivitetet përkatëse të kontratës që ka "nevojë për njohje" dhe që është i punësuar ose i përfshirë në zbatimin e kontratës;

b) mjetit që përdoret për transmetimin e informacionit të klasifikuar;

c) procedurave dhe mekanizmave për komunikimin e ndryshimeve që mund të lindin në lidhje me informacionin e klasifikuar, për shkak të ndryshimeve në nivelin e klasifikimit të sigurisë ose për shkak se mbrojtja nuk është më e nevojshme;

d) procedurës për miratimin e vizitave, hyrjes ose inspektimin nga personeli i një pale në ambientet e palës tjetër që mbulohen nga kontrata;

e) një detyrimi për të njoftuar në kohën e duhur autoritetin kompetent të kontraktorit për çdo marrje të kryer, të tentuar ose të pezulluar të informacionit të klasifikuar të kontratës;

f) përdorimin e informacionit të klasifikuar sipas kontratës vetëm për qëllimet që kanë të bëjnë

me objektin e kontratës;

g) respektimin rigoroz të procedurave për asgjësimin e materialeve të klasifikuara;

h) dhënien e informacionit të klasifikuar në bazë të kontratës me një palë të tretë vetëm me pëlqimin me shkrim të autoritetit kompetent të palës së origjinës.

4. Masat e kërkuara për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, si dhe procedura për vlerësimin dhe zhdëmtimin për humbje të mundshme të shkaktuara kontraktorëve nga përfitimi i paautorizuar i informacionit të klasifikuar, përcaktohet më hollësisht në kontratën përkatëse të klasifikuar.

5. Kontratat e lidhura me kontraktorë për informacionin e klasifikuar të nivelit 3A СЛУЖЕБНО ПОЛЗВАНЕ/RESTRICTED/I KUFIZUAR përmbajnë një dispozitë të përshtatshme që përcakton masat minimale që duhet të zbatohen për mbrojtjen e këtij informacioni të klasifikuar. Certifikata e sigurisë për këto kontrata nuk është e nevojshme.

#### Neni 9

##### **Vizitat**

1. Vizitorët marrin autorizim paraprak nga autoriteti kompetent i shtetit pritës vetëm nëse ata janë autorizuar për të marrë informacion të klasifikuar në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore të brendshme dhe nëse ata duhet të marrin informacion të klasifikuar ose të futen në ambientet ku ka dalë, është trajtuar ose depozituar informacioni i klasifikuar.

2. Për procedurat e vizitave bihet dakord ndërmjet autoriteteve kompetente.

3. Kërkesa për vizitë përmban informacionin e mëposhtëm:

a) Emrin e vizitorit, datën dhe vendin e lindjes, numrin e pasaportës (kartës së identitetit);

b) Shtetësinë e vizitorit;

c) Titullin e pozicionit të vizitorit dhe emrin e organizatës që ai/ajo përfaqëson;

d) Certifikatën e sigurisë të vizitorit të nivelit të përshtatshëm të klasifikimit;

e) Qëllimin, programin e propozuar të punës dhe datën e planifikuar për vizitë;

f) Emrin e organizatave dhe ambienteve që kërkohen të vizitohen.

4. Autoritetet kompetente të Palëve mund të bien dakord të përpilojnë lista të personave të autorizuar për të bërë vizita periodike. Këto lista janë të vlefshme për një periudhë fillestare prej dymbëdhjetë muajsh. Menjëherë sapo këto lista të jenë miratuar nga autoritetet kompetente të Palëve, kushtet e vizitave specifike rregullohen drejtpërdrejt me autoritetet përkatëse të organizatave që do të vizitohen nga këta persona, në pajtim me kushtet dhe termat e rëna dakord.

5. Secila Palë garanton mbrojtjen e të dhënave personale të vizitorëve, në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse.

#### Neni 10

##### **Cenimi i sigurisë**

1. Në rastin e cenimit të sigurisë, autoriteti kompetent, në shtetin e të cilit ka ndodhur cenimi i sigurisë, informon autoritetin kompetent të palës tjetër sa më parë të jetë e mundur dhe fillon/garanton hetimin e përshtatshëm. Pala tjetër, sipas rastit, bashkëpunon në hetim.

2. Në rastin e cenimit të sigurisë në një vend të tretë, autoriteti kompetent i palës dërguese ndërmerr veprimet, sipas paragrafit 1, nëse është e mundur.

3. Në çdo rast, pala tjetër informohet në lidhje me rezultatet e hetimit dhe merr raportin përfundimtar në lidhje me arsyet dhe masën e dëmit të shkaktuar.

#### Neni 11

##### **Shpenzimet**

Secila palë mbulon shpenzimet e shkaktuara gjatë përmbushjes së detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 12

##### **Dispozita të fundit**

1. Kjo Marrëveshje përfundohet për një periudhë të pacaktuar kohe dhe hyn në fuqi në datën e

marrjes së njoftimit të fundit, ku Palët njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e procedurave ligjore të brendshme të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

2. Kjo Marrëveshje mund të amendohet mbi bazën e pëlqimit të ndërsjellë me shkrim të të dyja Palëve. Këto amendime hyjnë në fuqi në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Secila palë mund ta prishë këtë Marrëveshje me njoftim me shkrim drejtuar palës tjetër. Prishja hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit. Pavarësisht nga prishja e kësaj Marrëveshjeje, i gjithë informacioni i klasifikuar i transferuar në pajtim me këtë Marrëveshje vazhdon të mbrohet në pajtim me dispozitat e saj, derisa pala e origjinës ta çlirojë palën pritëse nga ky detyrim.

4. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet me pajtim nëpërmjet konsultimeve ndërmjet Palëve, pa iu drejtuar juridiksionit të jashtëm.

Bërë në Sofje, më 27. 2. 2008, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, bullgare dhe angleze dhe të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, ka përparësi teksti në gjuhën angleze.

## **VENDIM**

**Nr.181, datë 5.5.2008**

### **PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE (ERE)**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, me propozimin e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE),

## **KUVENDI**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

## **VENDOSI:**


- I. Struktura e ERE-s është sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur.
- II. Organika e ERE-s është sipas lidhjes nr.2 bashkëlidhur.
- III. Numri i punonjësve është 32.
- IV. Vendimi i Kuvendit nr.95, datë 30.4.2007 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE)” shfuqizohet.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**

**Jozefina Topalli (Çoba)**

**STRUKTURA E ERE-S PËR VITIN 2008**

Lidhja nr.1



Lidhja nr.2

**ORGANIKA E ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

<b>POZICIONI</b>	<b>KATEGORIA</b>	<b>NUMRI</b>
<b>KRYETARI I ERE-s</b>		<b>1</b>
<b>ANËTARË BORDI</b>		<b>4</b>
Këshilltar i Bordit		1
Sekretar i Bordit		1
<b>DREJTORIA E LICENCIMIT DHE MONITORIMIT TË TREGUT</b>		
Drejtor drejtorie		1
<b>Sektori i Licencimit</b>		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist	III-b	1
<b>Sektori i Monitorimit të Tregut</b>		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist	III-b	1
<b>Sektori i Monitorimit të të Licencuarve</b>		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist	III-b	1
<b>DREJTORIA E ÇMIMEVE DHE TARIFAVE</b>		
Drejtor drejtorie		1
<b>Sektori i Strukturës së Tarifave</b>		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist	III-b	1
<b>Sektori i Analizës së Çmimeve</b>		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist	III-b	1
<b>DREJTORIA JURIDIKE DHE E MBROJTJES SË KONSUMATORIT</b>		
Drejtor drejtorie		1
<b>Sektori i Legjislacionit</b>		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist	III-b	1
<b>POZICIONI</b>	<b>KATEGORIA</b>	<b>NUMRI</b>

**Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit dhe  
i Marrëdhënieve me Publikun**

Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist	III-b	1

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE,  
ADMINISTRATË-FINANCËS DHE  
MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Drejtor drejtorie		1
-------------------	--	---

**Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë**

Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist finance	III-b	1
Specialist teknologjie dhe informacioni	III-b	1

Personel shërbimi		4
-------------------	--	---

---

**32**

**VENDIM  
Nr.182, datë 12.5.2008**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË AUTORITETIT TË  
KONKURRENCËS**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, me propozimin e Autoritetit të Konkurrencës


**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Miratohet struktura e Autoritetit të Konkurrencës, sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur.
- II. Miratohet organika e Autoritetit të Konkurrencës, sipas lidhjes nr.2 bashkëlidhur.
- III. Vendimi i Kuvendit nr.96, datë 30.4.2007 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës”, shfuqizohet.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)**

## STRUKTURA E AUTORITETIT TË KONKURENCËS



## ORGANIKA E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS

<u>POZICIONI</u>	<u>KATEGORIA</u>	<u>NUMRI</u>
<b>I.KRYETARI</b>		<b>(1)</b>
<b>II.KOMISIONERË</b>		<b>(4)</b>
<b>III.KABINETI</b>		<b>(3)</b>
Drejtor kabineti		1
Këshilltar		1
Sekretare		1
<b>IV.SEKRETARI I PËRGJITHSHËM</b>		<b>(1)</b>
<i>V. Sektori i Analizës dhe Studimeve</i>		<b>(3)</b>
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist	III-b	1
Specialist (IT)	III-b	1
<b>VI. DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË TREGUT</b>		<b>10</b>
Drejtor		1
<i>Sektori i Pozitës Dominuese</i>		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialistë	III-b	2
<b>Sektori Anti-Kartel</b>		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialistë	III-b	2
<i>Sektori i Përqendrimeve</i>		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialistë	III-b	2
<b>VII.DREJTORIA JURIDIKE DHE E PROCEDURAVE</b>		<b>(6)</b>
Drejtor		1
<i>Sektori i Hartimit të Legjislacionit dhe Procedurave</i>		<b>(2)</b>
Përgjegjë sektori	III-a	1
Specialist	III-b	1
<i>Sektori i Hetimit dhe Çështjeve Juridike</i>		<b>(3)</b>
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialistë	III-b	2

<b>POZICIONI</b>	<b>KATEGORIA</b>	<b>NUMRI</b>
<b>VIII. DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME</b>		<b>(7)</b>
Drejtor		1
<i>Spektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Dokumentacionit</i>		<b>(5)</b>
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist	III-b	1
Shofer		2
Pastruese		1
<i>Spektori i Shërbimeve të Financës</i>		
Specialist	III-b	1
<b>Gjithsej</b>		<b>35 punonjës</b>

**VENDIM**  
**Nr.183, datë 12.5.2008**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE  
TË PUNËS TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË  
PASURIVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, me propozimin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive,


**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Miratohet struktura e ILDKP-së, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur.
- II. Miratohet organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të ILDKP-së, sipas lidhjes nr.2 bashkëlidhur.
- III. Vendimi i Kuvendit nr.88, datë 8.9.2003 “Për miratimin e numrit të punonjësve dhe pagave të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”, shfuqizohet.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**STRUKTURA  
E INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE**



**ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS  
TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT  
DHE KONTROLLIT TË PASURIVE**

<b>Funksioni</b>	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>Kategoria/Klasa</b>
<b>I. Inspektor i Përgjithshëm</b>	1	<i>Ligji nr.9584, neni 4</i>
<b>Kabineti</b>		
Drejtor Kabineti	1	II-a VKM 901(2007)
Këshilltar	1	II-b VKM 901(2007)
Sekretar	1	Ligji nr. 9584, neni 7
<b>II. Inspektorët e lartë</b>		
Inspektorë	10	II- a + 10 000 lekë
Ndihmësinsektorë	8	II-b + 10 000 lekë
<b>III. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse</b>		
Drejtor i Përgjithshëm	1	II-a VKM 901(2007)
<b>III/1. Drejtoria e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse, me Publikun dhe Administrimi i Deklaratave</b>		
Drejtor	1	II-b VKM 901(2007)
<b>III/1/1. Sektori i Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse</b>		
Specialistë	2	III-b
<b>III/1/2. Sektori i Administrimit të Deklaratave të Interesave Privatë</b>		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	2	IV-a
<b>III.1/3. Sektori i Teknologjisë së Informacionit</b>		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	2	II-b

<b>Funksioni</b>	<b>Nr. i punonjësve</b>	<b>Kategoria/Klasa</b>
<b>III/2. Drejtoria e Buxhetit, Financës dhe Burimeve Njerëzore</b>		
Drejtor	1	II-b VKM 901(2007)
Specialist	1	III-b
Specialist financë-buxhet	1	IV-a
Magaziniere	1	Kl. IV VKM 477(2007)
Shofer i titullarit	1	Kl. VI, lidhja II/M VKM477(2007)
Shofer	1	Kl. IV, lidhja II/5 VKM 477(2007)
Punonjëse pastrimi	2	Klasa I VKM 477(2007)
Punonjës informacioni	1	Klasa II VKM 477(2007)
<b>Gjithsej</b>	<b>41 punonjës</b>	

## REZOLUTË

### PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE PËR VITIN 2007

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 103 të Rregullores së Kuvendit dhe me nenin 28 të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, pasi u njoh me Raportin për Veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2006, si dhe me raportin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat për vlerësimin e veprimtarisë së këtij institucioni, konstaton se:

- veprimtaria e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”;

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka zbatuar rekomandimet e Kuvendit, të shprehura në rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2006”.

#### **Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në drejtëm të:**

- përmirësimin të kuadrit ligjor për rregullimin dhe zgjerimin e tregut të sigurimeve, veçanërisht atyre të detyrueshme, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore dhe rregulloreve, me qëllim nxitjen e produkteve të sigurimit e të përgjegjësisë në sektorët e karburanteve, ndërtimit, minierave, koncesioneve dhe hotelerisë, mbështetur në kërkesat e tregut dhe në detyrimet që rrjedhin në kuadër të Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian;

- përmirësimin me sukses të procesit të zgjerimit të prezencës së kapitalit të huaj në shoqëritë e sigurimeve gjatë vitit 2007;

- mbikëqyrjes së tregjeve financiare jobankare dhe të performancës së subjekteve që veprojnë në këto tregje nëpërmjet aplikimit të modeleve me bazë risku dhe të një sistemi të strukturuar të analizës financiare, duke synuar identifikimin, parandalimin dhe reduktimin e shkallës së rreziqeve që kërcënojnë stabilitetin e tregut dhe interesat e konsumatorëve;

- përgatitjes së akteve nënligjore për investimin e provigjoneve, praktikave të trajtimit dhe vlerësimin të dëmeve në sigurime, marrëveshjet e risigurimit, veprimtarinë e ndërmjetësve në sigurime;

- rritjes së shkallës së transparencës të operatorëve në treg nëpërmjet përmirësimit të sistemit të tyre të raportimit;

- vendosjes së marrëdhënieve të bashkëpunimit me të gjithë aktorët dhe institucionet në vend, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në tërheqjen e praktikave më të mira;

- rritjes së shkallës së informimit të konsumatorëve për produktet e ofruara nga shoqëritë që ushtrojnë veprimtari në këto tregje, nëpërmjet mbështetjes nga një sistem elektronik i avancuar komunikimi;

- përmirësimin të mëtejshëm të kapaciteteve institucionale, nëpërmjet zhvillimit të një strukture

efektive, politikave të përzgjedhjes së burimeve njerëzore dhe trajnimit të vazhdueshëm të stafit.

**Kuvendi kërkon që për vitin 2008 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, midis të tjerave, të përqendrojë punën edhe në këto drejtime:**

- plotësimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e nënligjor të institucionit, në përputhje me kërkesat e tregjeve, praktikave të tjera dhe direktivat e Bashkimit Europian, me synim zgjerimin e mëtejshëm të tregjeve të sigurimeve dhe skemave private të pensioneve;
- rritjen e masës dhe cilësisë së mbikëqyrjes së tregjeve financiare jobankare për të zvogëluar dhe parandaluar rreziqet ndaj stabilitetit të tyre;
- bashkëpunimin me operatorët e tregjeve financiare jobankare për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe marrjen e masave organizative, me synim përmirësimin e raportit dëme/prime; uljen e shpenzimeve administrative dhe rritjen e efektivitetit të kapitalit;
- bashkëpunimin me Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Konkurrencës për garantimin e një tregu të lirë, konkurrues e transparent, në mbrojtje të interesave të klientëve;
- hartimin dhe miratimin e legjislacionit të ri, bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare për sigurimin e detyrueshëm dhe për pensionet private suplementare;
- fillimin e punës për hartimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit për mbrojtjen nga katastrofat;
- rritjen e bashkëpunimit me biznesin dhe përmirësimin e legjislacionit për të zgjeruar gamën e produkteve të siguruarra prej tij, veçanërisht të produkteve të sigurimit vullnetar.

5 maj 2008

## REZOLUTË

### PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2007

**Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,**

duke njohur e vlerësuar rolin kushtetues të Bankës së Shqipërisë për zbatimin e pavarur të politikës monetare dhe mbajtjen e administrimit e rezervave valutore të Republikës së Shqipërisë;

- duke vlerësuar rolin e këtij institucioni për ruajtjen e stabilitetit ekonomik e financiar të vendit;
- duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

**Konstaton se gjatë vitit 2007 Banka e Shqipërisë, me veprimtarinë e saj, ka ndikuar në:**

- forcimin e stabilitetit makroekonomik të vendit;
- ruajtjen e ritmeve të zhvillimit ekonomik e social të vendit;
- ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, duke mbajtur inflacionin brenda kufijve vjetorë të parashikuar;
- plotësimin e detyrimeve të programit monetar, që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe Marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar;
- rritjen e kreditimit të ekonomisë dhe veçanërisht asaj të sektorit prodhues privat, si dhe krijimin e regjistrit të kredive;
- ruajtjen e nivelit të parashikuar të rezervës valutore;
- përmirësimin e strukturës së portofolit të huamarrjes së brendshme publike, nëpërmjet zgjerimit të huamarrjes afatgjatë dhe emetimit për herë të parë të obligacioneve me maturim 7-vjeçar;
- reduktimin e stokut të parasë jashtë sistemit bankar;
- përmirësimin e sistemit dhe të infrastrukturës së pagesave;
- ruajtjen e stabilitetit të monedhës shqiptare kundrejt monedhave të huaja;
- zgjerimin dhe përmirësimin e strukturës së kapitalit aksionar bankar;
- forcimin e kapacitetit mbikëqyrës dhe kuadrit rregullator në fushën bankare;
- përmirësimin e administrimit të fondeve buxhetore dhe të rezultatit financiar të institucionit;

- mbajtjen e kontabilitetit, në përputhje me manualin kontabël të Bankës së Shqipërisë dhe ligjin, si dhe përmirësimin e tij, sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të bankave qendrore të vendeve europiane;
- rritjen e bashkëpunimit me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;
- përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor.

**Kuvendi kërkon që për vitin 2008 Banka e Shqipërisë të vazhdojë të punojë në këto drejtime:**

- rritjen e efektivitetit e të pavarësisë së institucionit, për të siguruar ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe realizimin e objektivave të tjerë monetarë, në përputhje me strategjinë afatmesme të zhvillimit të vendit, Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe Marrëveshjen me Fondin Monetar Ndërkombëtar;
- harmonizimin e politikës monetare me atë fiskale, me qëllim forcimin e mëtejshëm të stabilitetit ekonomik e financiar të vendit;
- nxitjen e kreditimit të ekonomisë, për të rritur investimet në sektorët prodhues dhe veçanërisht në sektorin e bujqësisë, si dhe marrjen e masave monitoruese për të shmangur risqet e mundshme;
- përdorimin e instrumenteve monetare, që nxisin rritjen e kreditimit dhe të depozitave në monedhën vendase, me qëllim mbrojtjen e interesave të klientëve dhe mbajtjen nën kontroll të normës së inflacionit;
- nxitjen e zhvillimit cilësor të sistemit bankar, për të mundësuar shërbime të reja për klientët dhe kosto më të ulët shërbimi;
- harmonizimin e legjislacionit bankar me atë të BE-së;
- rritjen e bashkëpunimit me organet ekzekutive, për të realizuar koordinimin e politikave monetare me ato të fushës fiskale, forcimin e tregut të kapitaleve, tregut të titujve, pensioneve etj.; bashkëpunimin me strukturat që ushtrojnë veprimtari në fushën e parandalimit të pastrimit të parave, për të minimizuar rastet e shkeljeve të Kodit Penal;
- forcimin e bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës, për të nxitur konkurrencën e lirë në sektorin bankar.

**Kuvendi përcakton si objektiva të tij, në raport me Bankën e Shqipërisë, forcimin e bashkëpunimit për:**

- zbatimin e politikave monetare, që garantojnë rritjen e qëndrueshmërisë së ekonomisë dhe zhvillimin e mëtejshëm të saj;
- përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit bankar dhe përafrimin e tij me atë të BE-së.

5 maj 2008

**REZOLUTË**

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURENCËS  
PËR VITIN 2007**

**Kuvendi i Republikës së Shqipërisë**, në përputhje me nenin 103 të Rregullores së Kuvendit, pasi u njoh me Raportin për Veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2007, **konstaton se:**

- veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është ushtruar në përputhje me kërkesat e nenit 164 të ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndryshuar me ligjin nr.9499, datë 3.4.2006.
- Autoriteti i Konkurrencës ka zbatuar rekomandimet e Kuvendit, të shprehura në rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2006”.

**Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për:**

- nxitjen e konkurrencës së lirë dhe mbrojtjen e konsumatorëve nëpërmjet ndërmarrjes së hetimit në tregun e telefonisë celulare, sigurimeve, importin e grurit, miellit dhe prodhimit të bukës, prodhimit të betonit, ndërhyrjen në tregun e telefonisë fikse dhe hapjen e hetimeve në tregun e energjisë;
- përafrimin e legjislacionit vendas me atë të BE-së, duke u fokusuar në plotësimin e legjislacionit sekondar në fushën e konkurrencës, në përputhshmëri me aktet legjislative të Bashkimit

European;

- nismën e marrë dhe kontributin e dhënë institucioneve të pushtetit qendror me sugjerime, në lidhje me shtreberimin dhe kufizimin e konkurrencës që rrjedh nga projektaktet ligjore dhe nënligjore.

**Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2008 të përmirësojë punën në këto drejtime:**

- thellimin e hetimeve të nisura dhe hapjen e hetimeve në tregje të tjera, për të eliminuar deformimet e konkurrencës dhe për të mbrojtur konsumatorët, veçanërisht në fusha të tilla të rëndësishme, si telekomunikacioni, sistemi bankar, energjia dhe tregu ushqimor;

- të monitorojë me kujdes sjelljen e kompanive private në përqendrime ose në rastet e privatizimit të pronës shtetërore, sidomos në sektorët strategjike, për të evituar rritjen subjektive të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve pas privatizimit dhe përqëndrimit;

- rritjen e profesionalizmit dhe përafrimin me standardet e autoriteteve homologe, në mënyrë që të forcohet pavarësia e institucionit;

- ndërgjegjësimin e aktorëve të ndryshëm dhe publikut për rëndësinë e konkurrencës dhe rolin e Autoritetit të Konkurrencës në ruajtjen e saj, si dhe bashkëpunimin me ta në këtë proces.

**Kuvendi i kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:**

- në dhënien dhe shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për monitorimin e tregut dhe hetimin e praktikave që deformojnë konkurrencën në treg;

- për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore, në mënyrë që ato të jenë të përputhura me ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe me Politikën Kombëtare të Konkurrencës;

- për rishikimin dhe plotësimin e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

5 maj 2008

## REZOLUTË

### PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE PËR VITIN 2007

**Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,**

- duke njohur rolin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, si një autoritet i pavarur për mbikëqyrjen e kuadrit rregullator të telekomunikacioneve dhe ushtrimin e kontrollit në këtë treg;

- duke vlerësuar implementimin nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve të politikave liberalizuese të tregut të telekomunikacioneve, si një ndër sfidat më të rëndësishme të sektorit;

- duke njohur përpjekjet e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve në përgatitjen e paketave rregullatore dhe përdorimin e instrumenteve të nevojshme për t’iu përgjigjur dinamikës së ndryshimeve;

- duke ritheksuar rëndësinë e forcimit të autoritetit të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve në sektorin e telekomunikacioneve;

- duke vlerësuar transparencën e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve në vlerësimin dhe shpalljen Operatorë me Fuqi të Ndjeshme në Treg të operatorëve publikë kombëtarë të telekomunikacioneve, që operojnë në tregun e telefonisë fikse dhe të lëvizshme;

**Konstaton se:**

- Përpjekjet e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve për mbikëqyrjen e kuadrit rregullator dhe politikave të zhvillimit të sektorit të telekomunikacioneve, edhe pse kanë pasur të gjitha hapësirat e nevojshme ligjore, kanë qenë të pamjaftueshme dhe nuk kanë sjellë rezultatet që priteshin prej saj.

- Nga ana e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve ka pasur vonesa të pajustificueshme në procesin e hartimit të metodologjisë së rregullimit të tarifave të operatorëve të telefonisë në përgjithësi dhe atyre celulare në veçanti, të shpallur Operatorë me Fuqi të Ndjeshme në Treg, gjë e cila ka pasur ndikim financiar të drejtpërdrejtë e të përditshëm për konsumatorin shqiptar, për shkak se kjo

metodologji rregullon tarifat e interkoneksionit mes operatorëve dhe tarifat e përdoruesve fundorë.

- Nga ana e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve ka pasur vonesa në hartimin e rregullores për ndarjen e llogarive dhe kontabilitetin e kostove për operatorët e telefonisë celulare, të shpallur Operatorë me Fuqi të Ndjeshme në Treg.

- Përpjekjet për realizimin e tenderit për konsulencë ndërkombëtare për llogaritjen e kostove të shërbimeve celulare nuk kanë qenë ato të duhurat.

**Kërkon:**

- forcimin e mëtejshëm të rolit dhe autoritetit të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve në sektorin e telekomunikacioneve;

- implementimin sa më shpejt të metodologjive të rregullimit të tarifave për Operatorët me Fuqi të Ndjeshme në Treg;

- vëmendjen maksimale të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve për sa i përket tarifave rekomanduese dhe marrëveshjeve të interkoneksionit dhe aksesit;

- angazhim të veçantë të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve në vlerësimin e Ofertave Referencë të Interkoneksionit të Operatorëve me Fuqi të Ndjeshme në Treg;

- përsheptimin dhe realizimin brenda 6 muajve të procesit të hartimit të rregullores për ndarjen e llogarive dhe kontabilitetin e kostove për operatorët e telefonisë celulare, të shpallur Operatorë me Fuqi të Ndjeshme në Treg;

- përgatitjen e paketave rregullatore që kërkon zbatimin e ligjit të ri “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij;

- përgatitjen e analizës së tregjeve të tjera brenda sektorit të telekomunikacioneve, përveç asaj të telefonisë fikse dhe celulare;

- finalizimin brenda vitit 2008 të transferimit dhe funksionimit të domain-it (ccTLD.al);

- ngritjen e Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Radiofrekuencave;

- angazhimin e ERT-së në përgatitjen e propozimeve të nevojshme për aktet ligjore apo nënligjore.

12 maj 2008

**REZOLUTË**

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË REDIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR  
PËR VITIN 2007**

**Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, pasi u njoh me raportin e Këshillit Drejtues të RTSH-së për vitin 2007, vëren se:**

- Këshilli Drejtues i RTSH-së raporton në Kuvendin pasi është plotësuar që prej disa muajsh me anëtarët e rinj të zgjedhur sipas ligjit;

- RTSH-ja vepron në kushtet e konkurrencës së operatorëve të tjerë në tregun mediatik dhe, për të balancuar përparësitë që zotëron, duhet dhe po punon për përmirësimin e parametrave teknologjikë dhe të kushteve të tjera që lidhen me ta;

- Këshilli i ri Drejtues ka bërë përpjekje për përmirësimin e punës së RTSH-së, duke ndërmarrë masa sidomos në ndryshimet e stafit ekzekutiv të këtij institucioni;

- ka përpjekje nga ana e strukturave drejtuese të RTSH-së për vënien në lëvizje të procesit të reformimit të RTSH-së drejt një televizioni krejtësisht publik, siç e përcakton ligji;

- kërkohet një mbështetje më e madhe e strukturave shtetërore, në mënyrë që RTSH-ja të realizojë këtë qëllim, si dhe një rishikim i kuadrit ligjor e normativ, që rregullon veprimtarinë e këtij institucioni.

**Kuvendi vlerëson se:**

- ka arritje në drejtim të rritjes së pavarësisë editoriale në programet e RTSH-së;

- ka realizime të kënaqshme në përmirësimin e strukturës programore të RTSH-së dhe drejtimin e saj kah publiku dhe veçanërisht pasurimin e kësaj strukture me emisione të reja dhe cilësore, që kanë rritur shikueshmërinë e këtij operatori;

- në raportin vjetor të Këshillit Drejtues të RTSH-së zë shumë pak vend analiza e problematikës së informimit të publikut, i cili është një nga tre objektivat kryesorë të funksionimit të një transmetuesi publik.

**Për këtë, Kuvendi kërkon nga Këshilli Drejtues dhe strukturat drejtuese të RTSH-së:**

- strukturat drejtuese të RTSH-së duhet të njihen më mirë me detyrimet ligjore dhe detyrimet që rrjedhin nga rezolutat e miratuara deri tani nga Kuvendi për veprimtarinë e RTSH-së, ku përcaktohen drejtime të rëndësishme të punës në RTSH;

- të zbatojnë detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 120 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në statutin e RTSH-së për publikimin e raportit të analizës financiare të Bordit të Administrimit të RTSH-së;

- të hartojnë brenda këtij viti kalendarik strategjinë e shndërrimit të plotë të RTSH-së në transmetues publik;

- të realizojnë sa më parë detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 71 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për mbulimin me sinjal të popullsisë dhe territorit në Republikën e Shqipërisë;

- të realizojnë detyrimet ligjore dhe institucionale që kanë të bëjnë me miratimin e strukturës organizative, programore dhe reformën e pagave në RTSH;

- RTSH-ja duhet të ngrejë struktura dhe mekanizma përkatës për realizimin e përthithjes së opinionit publik, për ta përdorur për formatimin e veprimtarisë së vet;

- të përgatisin dhe të hartojnë propozimet e veta në procesin e rishikimit të legjislacionit të ndërmarrë nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe në mënyrë të veçantë të statutit të RTSH-së, duke marrë në konsideratë vërejtjet dhe sugjerimet e bëra nga ekspertët e institucioneve ndërkombëtare dhe detyrimet që ka Republika e Shqipërisë në kuadrin e procesit të stabilizim-asociimit;

- të lirojnë mjediset e duhura për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit.

12 maj 2008

**DEKRET**

**Nr.5698, datë 5.5.2008**

**PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. Gentiana Avdyl Doda (Komina)  | 24. Evis Agim Hoxhaj            |
| 2. Gianna Qazim Doda             | 25. Leonard Llukan Plepi        |
| 3. Erini Zikuli Dima (Karanxha)  | 26. Artur Selahedin Maxhuni     |
| 4. Klodjan Abdyl Ismaili         | 27. Elton Bashkim Çaushmenaj    |
| 5. Altin Hekuran Kaja            | 28. Dhurata Jonus Pojana        |
| 6. Shpëtim Kasem Shkurti         | 29. Valentin Besnik Pajaziti    |
| 7. Ervi Shpëtim Shkurti          | 30. Korab Adem Domi             |
| 8. Geard Gezim Kupe              | 31. Engjellushe Ali Shehu       |
| 9. Rudens Mustafa Turku          | 32. Mimoza Hekuran Boci (Lamçe) |
| 10. Jonela Shpëtim Likaj (Herri) | 33. Gentjan Vangjel Koçollari   |
| 11. Eduard Idriz Korbi           | 34. Jay David Gentjan Koçollari |
| 12. Vojo Rrapush Barjamaj        | 35. Nuriye Rexhep Zhupi         |
| 13. Gëzim Lahim Daci             | 36. Ronaldo Artan Zhupi         |
| 14. Nikolin Gjergj Çobani        | 37. Silvester Artan Zhupi       |

15. Fatmar Fikret Bala
16. Fatbardha Rexho Selmani (Sinani)
17. Merita Hysen Durishta (Schmit)
18. Odeta Albert Nimonaj (Pëllumbi)
19. Lorin Dervish Nimonaj
20. Ardit Dervish Nimonaj
21. Rezarta Tomor Reimann (Meço)
22. Arben Idriz Delija
23. Silvana Gëzim Lehnert (Mansaku)

38. Rezart Isuf Klemme (Reka)
39. Mustafa Liman Dervishi
40. Ylber Xhevat Teluka
41. Shpendi Bilal Samarxhiu
42. Gëzim Elmaz Rakipi
43. Jannina Gëzim Rakipi
44. Joni Gëzim Rakipi
45. Mimoza Nesip Kaçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bamir Topi**

**DEKRET**  
**Nr.5699, datë 6.5.2008**

**PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- |                                    |                                       |
|------------------------------------|---------------------------------------|
| 1. Gentian Isuf Osmani             | 18. Daniela Imer Goralczyk (Ballushi) |
| 2. Edlira Luftim Fejzaj (Doko)     | 19. Dilaver Shahin Hysa               |
| 3. Ylli Sali Mustafa               | 20. Agron Etem Mustafa                |
| 4. Etleva Gani Hoxha               | 21. Drita Llazi Mustafa (Mino)        |
| 5. Servet Luan Bejko               | 22. Erion Beqir Dervishi              |
| 6. Lindita Mustafa Roth (Gjinushi) | 23. Ardian Shpëtim Domi               |
| 7. Alida Rasim Hisku-Keune (Hisku) | 24. Alessio Ardian Domi               |
| 8. Diana Reshit Kraus (Zela)       | 25. Andi Kujtim Çako                  |
| 9. Patri Rustem Qordja             | 26. Dashamir Gëzim Tufa               |
| 10. Silvia Edmond Xheneti          | 27. Erjon Kudret Metoja               |
| 11. Senada Edmond Xheneti          | 28. Valentina Pal Ndoj (Gurzaku)      |
| 12. Kastriot Rexhep Dapi           | 29. Alfa Shaban Ramadanov (Cania)     |
| 13. Liljana Llukan Walter (Dine)   | 30. Gëzim Kasem Kupe                  |
| 14. Bledar Shyqyri Levanaj         | 31. Raimonda Jakup Kupe (Kasemi)      |
| 15. Saimir Jaho Koca               | 32. Glen Gëzim Kupe                   |
| 16. Piro Niko Weber (Gjini)        | 33. Sonila Fadil Rusi (Gjata)         |
| 17. Leonard Pajtim Banushaj        |                                       |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)**  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 20.5.2008  
Doli nga shtypi më 20.5.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”  
Tiranë, 2008